



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.147, datë 15.06.2022

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zonja Elida Hoxhaj, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
2. Zonja Elida Hoxhaj, do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, nga data 23.06.2022 – 22.09.2022.
3. Të njoftohen për këtë vendim zonja Elida Hoxhaj, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
4. Gjatë periudhës së caktimit të përkohshëm zonja Elida Hoxhaj do të përfitojë shtesë mbi pagën referuese bazë, në masën 20%.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 15.06.2022.



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Alfred Balla

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

Anëtar
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurihan Seiti



ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Ludovik Dodaj

ANËTAR
Mirela Bogdan